



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.17/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, , si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 621/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha - Blakqori, pala ankuese , nga fshati dhe Përmbarduesi Privat, me datën 13.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-17/2023 i datës 07.08.2023, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese, , nga . si te pa bazuara.

II. Përmbarduesi Privat . si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore . , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr. 621/2022.

A r s y e t i m

Me datën 13.07.2023, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbarduesit Privat, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën dëgjimore, me të cilën pretendon

Me datën 13.07.2023, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbauesit Privat, duke pretenduar se përmbauesi privat, në mënyrë të vetëdijshme dhe me qëllim të pasurimit personal, ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, pasi i njëjti e ka shtyrë palën ankuese që të bëjë marrëveshje për pagesë të shumës prej 50.00 euro, nga të hyrat prej pensionit, që i ka 100.00 euro në muaj me arsyetimin se pa marrëveshje nuk mund të lejohet pensioni.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbauesit privat.

Me datën 07.08.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbauesin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbauese për këtë rast, të cilin raport e kanë prezantuar edhe në seancën dëgjimore.

Përmbauesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka theksuar se bllokimi i llogarisë është bërë konform dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbauese, ndërsa transferi është bërë pas pëlqimit të palës debitorë.

I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbauesin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbauesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, të paraqitura me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e palëve dhe ka analizuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, vlerësoi pretendimin e palës ankuese se a është bllokuar llogaria sipas procedurave dhe gjeti se llogaria e palës ankuese është bllokuar, mirëpo tërheqja e gjysmës së pensionit në shumën prej 50.00 euro, është bërë pasi pala e ka dhënë pëlqimin lidhur me tërheqjen e asaj shume, sipas pëlqimit të datës 17.05.2023. Për këto arsye komisioni vlerëson se përmbauesi privat nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet e masave disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbauese për rastin për të cilin është paraqitur ankesa, janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Mbi bazë të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr. 17/2023 datë 13.11.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.